



Buletini

- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- * Aktivitetet nga Programi për Hulumtime dhe Publikime
 - * Aktivitetet për stafin administrative të gjykatave dhe prokurorive
 - * Aktivitetet tjera

Qershor, 2017

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Kontrata për ndërtim dhe përgjegjësia e kontraktuesve

Më 2 qershor 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme, ka realizuar trajnimin me temë “Kontrata për ndërtim dhe përgjegjësia e kontraktuesve”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve që përmes diskutimeve dhe prezantimit të praktikave më të mira të zhvillojnë me sukses kontestet që ndërlidhen me kontratat e ndërtimit në ekonomi.

Në këtë trajnim u trajtuan çështjet si: karakteristikat dhe natyra juridike e kontratës së ndërtimit, shmangia nga projekti dhe punimet urgjente të paparashikuara, efekti i ndryshmit të çmimit të kontratës së ndërtimit si dhe e drejta e

porositësit për të kërkuar zbritjen e çmimit të kontraktuar. Më tej, vëmendje të veçantë i është kushtuar edhe kontratës së ndërtimit me dispozitë të veçantë si dhe përgjegjësitë për të metat.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, duke vënë në pah kornizën ligjore të aplikueshme të kontratës së ndërtimit dhe sfidat e vështirësitë në praktikë në rastet e kontesteve që ndërlidhen me kontratat e ndërtimit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe bashkëpunëtorë profesional të nivelit themelor.



Veprat penale sipas Kodit Doganor

Më 7 qershor 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme, ka realizuar trajnimin me temë “Veprat penale sipas Kodit Doganor”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve që përmes diskutimeve dhe prezantimit të praktikave më të mira të identifikojnë, hetojnë dhe gjykojnë këto vepra penale të cilat në përditshmërinë tonë janë bërë vepra të shpeshta penale

Në fokus të këtij trajnimi ishin veprat penale sipas Kodit Doganor dhe akcizave në Kosovë, specifikat e këtyre veprave si dhe veprat penale doganore të parapara sipas Kodit Penal të Kosovës.

Në trajnim gjithanshëm u trajtua edhe korniza ligjore sa i përket këtyre veprave si dhe detyrat

dhe kompetencat e doganës në luftimin e aktiviteteve ilegale, krimin kufitar, trafikut të drogës, armëve etj.

Vëmendje ju kushtua gjithashtu peshës së këtyre veprave penale dhe paraqitjes së tyre në forma të ndryshme si dhe obligimit të institucioneve relevante në luftimin e tyre nëpërmjet masave, veprimeve dhe mekanizmave përkatës meqë këto vepra rrezikojnë ekonominë e vendit.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, me ç ‘rast pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në praktikë në hetimin dhe gjykimin e këtyre veprave.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë, dhe prokurorë të nivelit themelor.



Punëtorja: “Barazia gjinore në procedurë gjyqësore”

Më 09 Qershor 2017, Akademia e Drejtësisë në mbështetje të projektit “Reforma Ligjore dhe Administrative” të GIZ-it, realizoi punëtorinë me temë: “Barazia gjinore në procedurë gjyqësore”.



Qëllimi i kësaj punëtorie ishte diskutimi i përbashkët i nevojave të gjyqtarëve dhe prokurorëve në nivel shtetëror për ngritjen e kapaciteteve rreth trajtimit të lëndëve lidhur me barazinë gjinore.

Me rastin e kësaj punëtorie u analizuan sfidat në zbatim të legjislacionit për barazinë gjinore, të metat e sistemit, lëndët ku më së shpeshti haset diskriminimi dhe pabarazia gjinore, praktikat e vendimmarrjes në gjykata dhe prokuroritë e Kosovës si dhe specifikat e tjera të procedurës.

Pjesëmarrësit patën rastin që të punojnë në grupe dhe të identifikojnë problemet ku më së shumti cenohet barazia gjinore veçanërisht në rastet e dhunës në familje, kontestet martesore, pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve dhe në kontestet e punës.

Nga rezultatet e punës në grupe tek rastet e dhunës në familje u parashtruan çështjet si: arsyetimi i pamjaftueshëm i vendimeve, masat për mbrojtje në shpërpushje mes veti, nevojat për trajtim me emergjencë, mbikëqyrja e zbatimit të masave dhe zbatimi në procedurë, përfaqësimi i mirëfilltë si dhe bashkëpunimi ndërinstytucional. Te kontestet martesore ndihma joadekuate e Qendrës për Punë Sociale,

kushtet ekonomike, ndarjen e pasurisë së përbashkët, vlerësimi adekuat i kontributit të bashkëshortëve, dallimi i pasurisë së veçantë me atë të përbashkët, disponimi i tërë pasurisë nga ana e meshkujve dhe çështje tjera si dhe diskriminimi sipas gjinisë në kontestet e punës.

Si rezultat i problemeve të identifikuara është ngritë nevoja nga gjyqtarët dhe prokurorët për tryeza të përbashkëta me të gjithë akterët duke përfshirë mbrojtësit e viktimave, gjyqtarët, prokurorët si dhe hetuesit policor, profilizimi i profesionistëve, caktimi i gjyqtarëve për dhunë në familje, fuqizimi i ndihmës juridike falas, formimi i grupeve kontaktuese si dhe trajnime të specializuara në shkathtësitë gjyqësore sipas fushave të caktuara, si dhe në arsyetimin e vendimeve.

Në vazhdim, pjesëmarrësit u pajtuan që një grup i caktuar prej gjyqtarëve, prokurorëve dhe akterë tjerë të përfshirë në këto procedura të bashkëpunojnë në drejtim të analizimit të vendimeve gjyqësore dhe konform kësaj analize të bëhet vlerësimi i nevojave se çfarë duhet të përfshijë moduli trajnues për barazinë gjinore.

Pjesëmarrës në këtë punëtori ishin gjyqtarë, prokurorë, hetues policor, përfaqësues nga Institucioni i Avokatit të Popullit si dhe nga Agjencioni për Barazi Gjinore.



Pranueshmëria e kërkesës në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme

Më 9 qershor 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme, ka realizuar trajnimin me temë “Pranueshmëria e kërkesës në Dhomën e Posaçme”.

Ky trajnim kishte për qëllim që të kontribuoj në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe thellimin e njohurive të pjesëmarrësve rreth pranueshmërisë së kërkesës, kritereve dhe zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore të LPK si dhe LDHP.

Gjatë këtij trajnimi u trajtuan aspektet e përgjithshme mbi pranueshmërinë e kërkesave, veprimet e gjykatës pas dorëzimit të kërkesës, kontrolli gjyqësor i plotësimit të kritereve të pranueshmërisë së kërkesës si dhe kriteret për pranueshmërinë e saj nga Dhoma e Posaçme.

Në trajnim gjithanshëm u trajtuan edhe rastet më të shpeshta të kritereve të pa plotësuara në

lëndët e dorëzuara në DHPGJS e cila u elaborua përmes rasteve praktike.

Pjesëmarrësit patën rastin që përmes ushtrimeve në grup të vlerësojnë nga shembujt praktik nëse janë plotësuar të gjitha kriteret e pranueshmërisë dhe në cilin drejtim gjykata ka nevojë të përqendrohet për të vlerësuar nëse janë plotësuar kriteret e pranueshmërisë së kërkesës, si dhe cilat veprime gjykata duhet ti ndërmerr gjatë këtij procesi para se të kalon te shqyrtimi i meritave të padisë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë nga Gjykata Supreme dhe Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, Gjykata e Apelit dhe gjykatat themelore si dhe bashkëpunëtorë profesional .



Aktgjykimi dhe llojet e tij sipas LPK-së

Më 14 qershor 2017, Akademia e Drejtësisë, ka realizuar trajnimin me temë “Aktgjykimi dhe llojet e tij sipas LPK-së”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte thellimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me vlerësimin e drejtë të kushteve specifike për nxjerrjen e aktgjykimeve si dhe arsyetimin tyre në mënyrë që të zbatojnë në mënyrë korrekte dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Gjatë këtij trajnimi është trajtuar dhe analizuar në përgjithësi aktgjykimi, llojet e aktgjykimeve dhe kushtet për nxjerrjen e tyre. Vëmendje të veçantë i është kushtuar aktgjykimit të pjesshëm, aktgjykimit në bazë të pohimit (arsyetimi, shkaqet e ankimimit) aktgjykimit në

bazë të heqjes dorë nga kërkesa, aktgjykimeve për shkak të padëgjueshmërisë/mosbindjes, për shkak të mungesës, aktgjykimit pa shqyrtim kryesor të çështjes si dhe aktgjykimit plotësues.

Më tej gjithanshëm është trajtuar edhe arsyetimi për secilin lloj të aktgjykimit. me ç ‘rast gjyqtarët pjesëmarrës nga shembujt praktik të prezantuar në këtë trajnim patën mundësinë e marrjes së udhëzimeve të qarta për të respektuar rregullat dhe ligjet.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët nga departamenti i përgjithshëm - divizioni civil dhe i kundërvajtjes të nivelit themelor nga të gjitha gjykatat e Kosovës.



Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve në luftimin e shpëlarjes së parave - Sesioni I

Më 16-17 qershor 2017, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, ka realizuar “Programin e specializuar të trajnimit në forcimin e kapaciteteve në luftimin e shpëlarjes së parave - Sesioni I”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve me elementet kyçe të veprave penale të shpëlarjes së parave në mënyrë që të ndërtohen dhe fuqizohen kapacitetet profesionale në luftimin e ekonomisë joformale.

Gjatë këtij sesioni trajnues u trajtua vepra penale e shpëlarjes së parave, financimi i terrorizmit dhe sanksionet, dobësitë e institucioneve financiare tek pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit, si dhe luftimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në praktikë.

Më tej, në kuadër të këtij sesioni të trajnimit në fokus ka qenë korniza ligjore e zbatueshme, kompetenca për hetimin e shpëlarjes së parave si dhe Njësia për Intelligence Financiare dhe subjektet raportuese si institucion qendror dhe i pavarur kombëtar përgjegjës për kërkimin, marrjen, analizimin dhe shpërndarjen tek autoritetet kompetente dhe bërjen publike të informacionit në lidhje me shpëlarjen potenciale të parave dhe financimin e terrorizmit.

Gjithashtu, u diskutuan edhe veprat e ndërlidhura penale, problemet themelore rreth ekzaminimit të mashtrimeve dhe çështje tjera specifike të këtyre llojeve të veprave penale .

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë nga Gjykata e Apelit dhe ato themelore dhe prokurorë nga Prokuroria Speciale e Kosovës dhe të nivelit themelor.



Ngrirja e përkohshme asetëve, sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë

Më 21 qershor 2017, Akademia e Drejtësisë ka realizuar trajnimin me temë “Ngrirja e përkohshme asetëve, sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte krijimi i praktikave më të mira në drejtim të zbatimit të dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me ngrirjen e përkohshme të asetëve, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë.

Me rastin e këtij trajnimi janë trajtuar çështjet rreth sekuestrimit dhe konfiskimit sipas Kodit të Procedurës Penale (KPP) përfshirë edhe dispozitat e Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Përfiturar me Vepër Penale i cili ofron mundësi për

sekuestrim dhe konfiskim.

Vëmendje të veçantë i është kushtuar edhe krahasimeve të legjislacionit vendor dhe atij ndërkombëtarë, rasteve të praktikës gjyqësore, si dhe prezantimit të trendëve globale në këtë fushë.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen në praktikë në rastet e ngrirjes së përkohshme të asetëve, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor.



Procedura për privatizimin e subjekteve nga Agjencia Kosovare e Privatizimit

Më 23 qershor 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV, ka realizuar trajnimin me temë “Procedura për privatizimin e subjekteve nga Agjencia Kosovare e Privatizimit”

Qëllimi i këtij trajnimi ishte thellimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me procedurat e privatizimit të subjekteve nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, rolin e Agjencisë në procesin e privatizimit; verifikimin dhe shpalljen e fituesit të përkohshëm; aprovimin dhe refuzimin e ofertës; dhe ofertuesit me ndalesa ofertimi.

Gjithashtu trajnimi ofroj përgjigje edhe në pyetjet: A ka shkelje të procedurave nga AKP, me rastin e aprovimit apo refuzimit të ofertave? Në çfarë gjendje ndodheshin NSH-të në Kosovë pas luftës, sa ishin borxhet e tyre? Cilat janë vështirësitë e gjyqësorit në zgjidhjen e rasteve të kësaj natyre që paraqiten para saj?

Në këtë trajnim u shqyrtua edhe gjendja e përgjithshme në Kosovë që i parapriu paraqitjes së nevojës për privatizimin dhe likuidimin adekuat dhe me kohë të ndërmarrjeve në pronësi shoqërore. Marrë parasysh se pasiguria e vazhdueshme juridike lidhur me pronësinë e këtyre ndërmarrjeve dhe asetëve ishte duke i penguar në masë të madhe investimet dhe

funksionimin e këtyre ndërmarrjeve dhe asetëve, po ashtu duke kuptuar se kjo pasiguri juridike ishte duke ndikuar në mënyrë serioze dhe negative në situatën e përgjithshme ekonomike dhe sociale në Kosovë, u shtrua edhe nevoja e nxjerrjes së ligjeve, akteve ligjore dhe nënligjore të cilat rregullojnë çështjen e procesit të privatizimit.

Gjithanshëm u trajtua dhe u analizua problemet aktuale në praktik, duke njohur dhe kuptuar më mirë rolin e Agjencisë në procesin e privatizimit në Kosovë; zbatimin e drejtë të procedurave për privatizimin e subjekteve; dhe identifikimin se cilët janë personat me ndalesa ofertimi.

Këto dhe dilema tjera të ngritura nga pjesëmarrësit u trajtuan në thellësinë e tyre përmes diskutimeve të pjesëmarrësve dhe elaborimeve të trajnuesve duke nxjerr përfundime adekuate.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarë të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, gjyqtarët e gjykatave themelore - divizioni civil dhe zyrtarë të AKP-së.



Arsyetimi i vendimeve gjyqësore në fushën civile

Më 28 qershor 2017, Akademia e Drejtësisë, ka realizuar trajnimin me temë “Arsyetimi i vendimeve gjyqësore në fushën civile”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve në lidhje me teknikat dhe metodologjinë e shkrimit dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore në fushën civile.

Në kuadër këtij trajnimi u elaboruan udhëzimet teorike dhe praktike në hartimin e vendimeve gjyqësore me qëllim që një vendim të jetë sa më profesional dhe me një arsyetim të detajuar dhe mirë të argumentuar.

Në fokus të këtij trajnimi ishte Metoda katër-hapëshe e arsyetimit ligjor e njohur si “IRAC” (që do të thotë Çështja-Rregulla-Analiza-Përfundimi). Pjesëmarrësit patën rastin

të njoftohen si mund të zbatohet metoda IRAC gjatë hartimit të vendimeve gjyqësore, për strukturën e vendimeve që e përcakton kjo metodë si dhe vështirësitë në aplikimin e metodës IRAC në vendimet gjyqësore të lëmisë civile.

Gjatë trajnimit u përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike të përcjella me shembuj praktik, ku pjesëmarrësit ishin aktiv duke marrë pjesë në diskutime me prezantuesin pas çdo shpjegimi.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor.



Hetimi financiar

Më 29-30 qershor 2017, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me projektin “Bashkëpunimi Juridik Ndërkombëtarë në Drejtësinë Penale”, i financuar nga BE-ja dhe i zbatuar nga Rrjeti i Prokurorëve të Ballkanit Perëndimor, ka realizuar punëtorinë me temë “Hetimi financiar”.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte të ndihmoj pjesëmarrësit në identifikimin e treguesve kryesor për një proces më efikas të hetimit financiar, të zbatojnë drejt legjislacionin ekzistues, të interpretojnë drejt procedurën e hetimeve të veprat penale me element të krimit financiar si dhe të mbështesë unifikimin e praktikës gjyqësore.

Fokusi primar i kësaj punëtorie ishte trajtimi i sfidave me të cilat duhet ballafaquar gjatë gjurmimit, menaxhimit dhe rikuperimit të të ardhurave ose pasurive të tjera që kanë të bëjnë

me krimin, si në nivel kombëtar po ashtu edhe atë ndërkufitar.

Gjithashtu, janë trajtuar çështjet lidhur me përdorimin e informatave të inteligjencës për identifikimin e mjeteve që ndërlidhen me asetet, luftimi dhe masat për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit si dhe me theks të veçantë rikuperimi i aseteve nga perspektiva e zbatuesve të ligjit.

Punëtorja ishte e karakterit interaktiv dhe e shoqëruar me raste nga praktika gjyqësore si dhe punës në grupe të pjesëmarrësve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin prokurorë nga të gjitha nivelet, zyrtarë nga Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës dhe Njësia e Intelgjencës Financiare.



Gjykimi i të miturve dhe madhorëve në një proces gjyqësor

Më 30 qershor 2017 Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me UNICEF-in ka realizuar trajnimin me temë “Gjykimi i të miturve dhe madhorëve në një proces gjyqësor“.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me infrastrukturën ligjore për procedurën që duhet zbatuar në rastet kur të miturit në bashkëpunim me madhorin kanë kryer vepra të ndryshme penale.

Ky trajnim, trajtoj çështjen e gjykimit të të miturve dhe madhorëve, kur në bashkëkryerje, ndihmë apo shtytje kanë kryer vepra të ndryshme penale meqë në praktikë ka mjaftë raste kur të miturit kryejnë vepra penale së bashku me persona madhor. Gjithanshëm është trajtuar procedura ndaj të miturit e cila nuk

është identike me procedurën ndaj personave madhor, e cila përveç tjerash është urgjente dhe në të cilën marrin pjesë persona dhe institucione që nuk marrin pjesë në procedurën ndaj madhorëve.

Gjatë trajnimit vëmendje iu kushtua edhe rasteve të ndarjes së procedurës, si dhe problemeve tjera të cilat shfaqen në praktikë.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në praktikë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare (PTF)

Aktivitetet e realizuara në PTF- qershor 2017

Akademia e Drejtësisë, në drejtim të përmbushjes së programit trajnues, ka vazhduar me realizimin e aktiviteteve të planifikuara në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar, të cilin janë duke e vijuar prokurorët e shtetit të sapoemëruar.



Nën-moduli “Provat në procedurën penale” është përfunduar gjatë muajit qershor, duke realizuar në këtë formë edhe katër (4) sesione trajnuese, në kuadër të të cilave janë trajtuar: sigurimi i provave me anë të masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit, provat në fazën e hetimeve, bastisjet-kontrolli, sekuestrimi i përkohshëm dhe ekspertizat, marrja e provave gjatë hetimeve, deklarimi i të pandehurit dhe dëshmia e dëshmitarit, si dhe provat e pranueshme.

Në kuadër të trajnimit teorik, është realizuar nën-moduli tjetër “I pandehuri në procedurën penale”, ku janë mbajtur pesë (5) sesione trajnuese dhe janë trajtuar këto çështje: i pandehuri si subjekt i procedurës penale, deklarimi i të pandehurit si provë, të drejtat dhe detyrimet e tij gjatë procedurës penale, pozita e të pandehurit pas ngritjes dhe gjatë procedurës së konfirmimit të aktakuzës, i pandehuri gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe e drejta për

ushtrimin e mjeteve juridike, dhe i pandehuri gjatë procedurës së shkurtër dhe procedura për ndihmë juridike ndërkombëtare.

Po ashtu, janë realizuar dy (2) sesione trajnuese nga nën-moduli “Dëshmitarët dhe të dëmtuarit në procedurën penale” ku janë trajtuar: kuptimi dhe llojet e dëshmitarëve dhe marrja në pyetje dhe e deklaratave të dëshmitarëve para ngritjes së aktakuzës. Gjatë muajit qershor gjithashtu janë realizuar një (1) sesion trajnimi nga nën-moduli “E drejta e BE-së” dhe një sesion për “Ngritja e shkathtësive sociale të prokurorëve”.

Nën-moduli “Zhvillimi i shkathtësive gjyqësore” i cili kishte filluar në muajin maj, është përmbyllur në këtë periudhë, ku janë realizuar pesë (5) sesione trajnimi. Pas përfundimit të këtij nën-moduli është realizuar “Simulim gjykimi”, ku prokurorët e sapoemëruar, në një sallë të vërtetë gjykimi, të ndarë në dy grupe, realizuan në mënyrë të suksesshme këtë aktivitet.

Në kuadër të trajnimit praktikë, prokurorët e sapoemëruar kanë vazhduar praktikën në prokuroritë përkatëse konform orarit të përcaktuar me program, nën mbikëqyrjen e mentorëve të tyre.

Ndërsa sa i përket trajnimeve në institucionet jo gjyqësore, prokurorët e sapoemëruar kishin rastin të shohin nga afër punën e këtyre institucioneve: Shërbimit Korrektues të Kosovës (Qendrës Korrektuese në Lipjan) dhe Policisë së Kosovës.

Trajnimi praktik në Shërbimin Korrektues të Kosovës (Qendra Korrektuese Lipjan)

Më 21 qershor 2017, Akademia e Drejtësisë në koordinim me Shërbimin Korrektues të Kosovës, ka realizuar trajnimin për prokurorët e sapoemëruar në Qendrën Korrektues në Lipjan.

Qëllimi i trajnimit konsistonte në rëndësinë, që prokurorët e sapoemëruar të njohin punën dhe mandatin që ka Shërbimi Korrektues në Përgjithësi dhe Qendra Korrektuese në Lipjan në veçanti.

Fillimisht, në kuadër të kësaj vizite, Drejtori i Qendrës Korrektues në Lipjan, prezantoi një historik të shkurtër të themelimit dhe zhvillimit, rolin dhe mandatin e qendrës, strukturën e organizimit dhe funksionimit të saj si dhe kategoritë e personave që janë në mbajtje në këtë qendër korrektuese. Në këtë

kuadër, Drejtori përmendi sfidat dhe vështirësitë me të cilat aktualisht ballafaqohen në përmbushje të mandatit të tyre ligjor. Pjesëmarrësit u interesuan, duke parashtruar pyetje rreth punës së Qendrës Korrektues në Lipjan dhe bashkëpunimit me institucionet e gjyqësorit.

Me tej, prokurorët e sapoemëruar, së bashku me stafin e qendrës, vizituan ambientet e institucionit, duke parë në këtë formë, për së afërmi të gjitha mjediset me të cilat disponon Qendra Korrektuese në Lipjan, kushtet dhe aktivitetet që ajo ofron për personat që janë në mbajtje brenda saj.

Përfutues të këtij trajnimi ishin prokurorët e sapoemëruar të gjeneratës së VI të PTF-së.



Trajnimi praktik në Policinë e Kosovës

Më 28 qershor 2017, në kuadër të vizitave në institucionet jo-gjyqësore, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, ka realizuar trajnimin me prokurorët e sapoemëruar në këtë institucion.

Ky trajnim, kishte për qëllim që prokurorët e sapoemëruar të avancojnë njohuritë e tyre rreth mandatit, rolit, strukturës dhe punës praktike të Policisë së Kosovës.

Fillimisht, u prezantua sistemi i edukimit në Policinë e Kosovës, mundësitë dhe programet e trajnimit që ofrohen për zyrtarët policor në nivele të ndryshme. Me tej u elaborua baza ligjore dhe struktura e Policisë së Kosovës, më saktësisht u prezantuan roli, kompetencat dhe veprimet hetimore të drejtorive si: Drejtorisë për hetimin e krimit të organizuar, Drejtorisë për trafikim me qenie njerëzore, Drejtorisë për mbështetje të hetimeve, dhe Drejtorisë për

hetimin e trafikimit me narkotikë. Po ashtu, në kuadër të elaborimit të funksioneve të Policisë së Kosovës, u trajtua edhe komponenta e Inteligjencës, dhe bashkëpunimit juridik ndërkombëtarë.

Mbështetur në faktin që puna e prokurorëve është e ndërlidhur ngushtë me punën e Policisë, prokurorët e sapoemëruar kishin rastin që të ngritin çështje me interes për punën e tyre praktike, për bashkëpunimin aktual dhe formave adekuate të bashkëpunimit në të ardhmen mes Policisë dhe Prokurorive përkatëse.

Përfitues të këtij trajnimi ishin prokurorët e sapoemëruar të gjeneratës së VI të PTF-së.



Aktivitetet nga Programi për Hulumtime dhe Publikime

Ceremonia e promovimit të publikimeve

Me 07 Qershor 2017, Akademia e Drejtësisë në mbështetje të projektit “Reforma Ligjore dhe Administrative” të GIZ-it, realizoi ceremoninë e promovimit të tre publikimeve ligjore: Revista Opinio Juris, Format e Shkresave në Procedurat Penale si dhe Përmbledhja e Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ligjore Ndërkombëtare.



Të pranishmëve në këtë ceremoni iu drejtuan me një fjalë rasti, Drejtuesi i Projektit të GIZ-së z. Karl Weber, u.d. Drejtori i Akademisë së Drejtësisë, z. Besim Morina, dhe Fejzullah Hasani, anëtar i Këshillit të Redaksisë së publikimeve të Akademisë. Ndërkaq në emër të autorëve të publikimeve, z. Valon Totaj, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, z. Besim Kelmendi, Prokuror në Prokurorinë e Shtetit si dhe znj. Remzije Istrefi, profesoreshë në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës.

Drejtuuesi i projektit të GIZ-së z. Karl Weber, në fjalimin e tij mes tjerash tha “Këto publikime janë rezultat i bashkëpunimit disa vjeçar me Akademinë e Drejtësisë duke shprehur falënderim të veçantë njëkohësisht edhe për autorët e këtyre publikimeve”.

Njëherit, i njëjti theksoi se GIZ në kuadër të projektit për Reformën Ligjore dhe Administrative do vazhdojë edhe më tutje të përkrahë ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve institucionale të Akademisë së Drejtësisë.

U.D Drejtori i Akademisë së Drejtësisë z. Besim Morina mes tjerash theksoj se “Akademia e Drejtësisë përveç trajnimeve në mandatin e saj ligjor ka edhe veprimtarinë kërkimore dhe botuese. Bazuar në këtë, në mbështetjen e fuqishme të GIZ-it është realizuar paraprakisht një proces i vlerësimit të nevojave të gjyqtarëve dhe prokurorëve në fushën e botimeve prej të cilës edhe kanë rezultuar këto publikime, që padyshim do të jenë mbështetje në punën profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor”.

Ndërsa, z. Fejzullah Hasani, në fjalën e tij përgëzoi Akademinë e Drejtësisë dhe GIZ-in, për këto publikime, duke ditur mungesën në botime ligjore në gjuhën shqipe dhe nevojën që institucionet kompetente do të duhej t’i kushtonin me ndarjen e buxhetit për fushën e publikimeve.





Në emër të autorëve të punimeve për revistën “Opinio Juris”, z. Valon Totaj falënderoi Akademinë për mundësinë e dhënë që rezultatet e hulumtimeve gjate punës praktike në gjykata dhe prokurori ti shprehin përmes kësaj reviste, veçanërisht për disa tema që nuk janë trajtuar shumë nga literatura juridike dhe që kanë pasur mundësi të hapin debat në këtë çështje.

Për “Përmbledhjen e formave të shkresave në procedurën penale” foli z. Besim Kelmendi i cili në fjalën e tij mes tjerash tha “Këto forma do të jenë në shërbim të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe se qëllimi i hartimit të këtyre formave të shkresave ka qenë lehtësimi i punës në gjyqësor duke pasur parasysh se këto forma do të jenë edhe në formatin elektronik për çka do të kontribuojnë edhe në efikasitetin e punës edhe në unifikimin e praktikës”

Në emër të autorëve të “Përmbledhjes së Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ligjore Ndërkombëtare” foli znj. Remzije Istrefi, e cila mes tjerash theksoi se “Të drejtat e njeriut janë kategori kushtetuese e Republikës së Kosovës prandaj është pa si nevojë që të gjitha marrëveshjet dhe instrumentet ligjore ndërkombëtare në këtë fushë të përmblihen në gjuhën shqipe në mënyrë që komuniteti ligjor, veçanërisht gjyqtarët dhe prokurorët të kenë qasje dhe të mund të bëjnë krahasime me kornizën ligjore ndërkombëtare”

Në këtë ceremoni morën pjesë, anëtarë nga Këshilli i Redaksisë së Publikimeve të Akademisë profesor universitar, autorë të punimeve dhe përmbledhjeve, gjyqtarë, prokurorë si dhe stafi i Projektit të GIZ-it si dhe nga Akademia e Drejtësisë.

Aktivitetet për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive

Kursi Hyrës – Moduli 1

Me 05-09 qershor 2017, Akademia e Drejtësisë ka organizuar trajnimin pesë ditor për pjesëtarët e sapoemëruar të administratës së gjykatave dhe prokurorive “Kursi Hyrës – Moduli 1”.



Ky trajnim hyrës duke u fokusuar në fushat më të rëndësishme, kishte për qëllim ndërtimin e kapaciteteve profesionale të pjesëmarrësve, me theks të veçantë në performancën e tyre praktike të përditshme për nxitjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara në përputhje me politikën, standardet e aplikueshme dhe me kërkesat ligjore.

Në kuadër të këtij moduli trajnues janë trajtuar etapat e zhvillimit historik të reformës gjyqësore dhe asaj prokuroriale pas vitit 1999,

ndryshimet legislative lidhur me funksionimin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial, dispozitat kushtetuese dhe legjislacionin në fuqi lidhur me sistemin gjyqësor dhe prokurorial në Republikën e Kosovës si dhe struktura aktuale e gjykatave dhe prokurorive si dhe kompetencat e tyre në Republikën e Kosovës. Gjithashtu janë trajtuar dokumentet zyrtare, parimet dhe rregullat e Kodit të Etikës dhe sjelljes profesionale për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive, shërbimet e orientuara në cilësi në shërbim të qytetarëve, si dhe planifikimi, menaxhimi i kohës dhe stresit gjatë ushtrimit të detyrave të punës.

Metodologjia e aplikuar në trajnim ishte e kombinuar me shpjegime teorike dhe qasje interaktive që ishin të përshtatshme dhe nxitën pjesëmarrësit të zhvillojnë debat dhe të paraqesin sfidat që kanë hasur në praktikë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin pjesëtarët e sapoemëruar të administratës së gjykatave dhe prokurorive të pozitave të ndryshme si: bashkëpunëtor profesional, zyrtar ligjor, zyrtar për buxhet dhe financa, referent dhe zyrtar tjerë.



Aktivitetet tjera

Takimi i radhës i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë

Me 1 qershor 2017, është mbajtur takimi i tretë i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, i udhëhequr nga Kryesuesi i Këshillit Drejtues, Kryeprokurori i Shtetit z. Aleksandër Lumezi.

Gjatë këtij takimi, Këshilli Drejtues fillimisht mori vendim për fillimin e procedurës për emërimin e Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë, konform Rregullores për Emërimin dhe Shkarkimin e Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë.

Në vazhdim, me qëllim të zbatimit të këtij procesi, Këshilli Drejtues themeloi Komisionin për Procedurën e Përzgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë.

Këshilli Drejtues gjithashtu, shqyrtoi dhe miratoi me disa rekomandime, rregulloret e hartuara dhe propozuara nga Komisioni për Çështje Normative i Akademisë së Drejtësisë. Rregulloret e miratuara janë Rregullorja për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë dhe Rregullorja për Programin e

Trajnimit Fillestar, të cilat u vlerësuan si rregullore me një rëndësi shumë të madhe për punën dhe funksionimin e Akademisë së Drejtësisë.

Më pas Këshilli Drejtues, shqyrtoi dhe miratoi projekt buxhetin e Akademisë së Drejtësisë për vitin 2018 si dhe planifikimet për vitin 2019 dhe 2020. Ky projekt buxhet u vlerësua si i domosdoshëm për zbatimin e mandatit ligjor dhe funksionimin e Akademisë së Drejtësisë, veçanërisht për zbatimin e procesit të transformimit nga Instituti Gjyqësor i Kosovës në Akademinë e Drejtësisë.

Gjatë shqyrtimit të projekt buxhetit, diskutimet u përqendruan në nevojën që të mbështetet kërkesa e Akademisë së Drejtësisë për ndërtimin e ndërtesës me qëllim të zbatimit të funksioneve ligjore të saj në mënyrë më efektive.



Vizitë e Delegacionit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë së Shqipërisë në Akademinë e Drejtësisë

Me 2 qershor 2017, Akademia e Drejtësisë ka pritur në vizitë një delegacion nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë së Shqipërisë.

Qëllimi i vizitës ishte njohja për së afërmi me punën dhe aktivitetet e Akademisë së Drejtësisë, shkëmbimi i ideve dhe i përvojave për praktikën më të mira me qëllim të organizimit të trajnimeve gjyqësore, si dhe ngritja e nivelit të bashkëpunimit në mes të Akademisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë

të Drejtësisë dhe institucioneve tjera të sistemit gjyqësor të Shqipërisë.

Në këtë kuadër u diskutuan organizimi i sistemit të drejtësisë dhe sistemit gjyqësor në përgjithësi, roli, funksioni dhe struktura e Akademisë së Drejtësisë, të arriturat dhe sfidat, korniza ligjore, mandati, si dhe çështje tjera me interes të përbashkët në sferën e trajnimeve gjyqësore.



Punëtori për hartimin e akteve normative të Akademisë së Drejtësisë

Prej 14 deri me 17 qershor 2017, Akademia e Drejtësisë realizoj punëtorinë për hartimin e akteve normative që rrjedhin si obligim pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Akademinë e Drejtësisë.

Gjatë kësaj punëtorie, Komisioni për Çështje Normative i themeluar nga Këshilli Drejtues i Akademisë së bashku me grupin punues nga staf i Akademisë, përcaktuan metodologjinë e punës dhe hartuan draftet e akteve normative të përcaktuara sipas Ligjit për Akademinë e Drejtësisë si në vijim: Rregulloren për punën e Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë, Rregulloren për Trajnues dhe Mentor si dhe Rregulloren për Tarifat e Trajnimeve për Avokatë dhe Profesionet e tjera të Lira.

Me rastin e kësaj punëtorie, Komisioni ka diskutuar edhe për strukturën e Rregullores për Organizim dhe Sistematizim të Brendshëm të Akademisë duke dhënë elementet bazë mbi të cilat do të hartohet ky akt. Kjo rregullore do të jetë në fokus të punëtorisë së radhës për të përmbushur aktet obligative të cilat i përcakton Ligji për Akademinë e Drejtësisë.

Gjatë analizës dhe diskutimeve të shumta në punëtori, me rastin e hartimit të këtyre akteve, Komisioni udhëhoq nga parimet dhe standardet e avancuara për hartim të normave juridike me qëllim që ato të jenë të qarta, funksionale dhe të zbatueshme në praktikë.



Punëtorja “Bashkëpunimi mbi krimin kibernetik me fokus të ardhurat nga krimi përmes internetit”



Nga data 19-25 qershor 2017, në Budva të Malit të Zi, gjyqtarë dhe prokurorë nga Kosova kanë marrë pjesë në punëtorinë për trajnimin e trajnuesve për shtetet e Ballkanit Perëndimor me temë: “Bashkëpunimi mbi krimin Kibernetik, me fokus të ardhurat nga krimi përmes internetit” i organizuar nga Zyra e Programit për Krim Kibernetik të Këshillit të Evropës, njësia përgjegjëse e vendosur në Bukuresht.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte ngritja e kapaciteteve profesionale në zbatimin e hetimeve dhe procedurave që duhet ndjekur për luftimin e krimit kibernetik.

Punëtorja ishte e fokusuar në dhënien e njohurive për krimin kibernetik dhe provat elektronike, hetimin financiar dhe procedura që duhet ndjekë për krimet kibernetike, veprimet e policisë, prokurorisë dhe gjykatës, procedurat ligjore dhe teknologjike që duhet ndërmarrë në këto raste, dhe ndërmarrja e veprimeve në raste urgjente lidhur me bashkëpunimin vendor dhe ndërkombëtar dhe efikasiteti.

Ditët e para të punëtorisë pjesëmarrësit kishin mundësinë të përfitojnë njohuri më të detajuara lidhur me zbatimin e hetimeve për rastet e

krimeve kibernetike, ndërmarrjen e veprimeve hetimore të prokurorit në identifikimin dhe zbulimin e të dyshuarve të krimeve online, teknologjitë informative dhe komunikuese të përdorura, zbatimin e masave të fshehta dhe procedurave për sekuestrimin e aseteve dhe dobisë pasurore të fituar me kryerjen e këtyre veprave penale dhe veprave penale të kryera me anë të internetit si: pornografia e fëmijëve dhe shpëlarja e parave, e po ashtu mësimi i praktikave, metodave dhe shkathtësive më të avancuara për cilësitë e trajnuesit.

Një pjesë e punëtorisë i është kushtuar diskutimeve lidhur me dispozitat e ligjit material të secilit vend që zbatohen lidhur me veprat penale të krimeve kibernetike dhe harmonizimit të tyre me aktet ndërkombëtare, konkretisht me Konventën e Budapestit, Vendimin Kornizë të Këshillit të Evropës dhe Direktivat e BE-së. Pjesa tjetër e trajnimit ka përmbajtur tema dhe diskutime për Pikat e Kontaktit të vendosura në secilin shtet për shkak të lehtësimit të bashkëpunimit vendor dhe ndërkombëtar, me theks të veçantë në raste urgjente. .

Në bazë të udhëzimeve, secili vend pjesëmarrës, ka bërë prezantimin si trajnues për krimin kibernetik para ekspertëve dhe pjesëmarrësve, ku edhe janë vlerësuar shkathtësitë trajnuesve nga ekspertët e Komisionit Evropian

Pjesëmarrësit nga Kosova ofruan propozimet lidhur me nevojat specifike për luftimin e krimit të kësaj fushe, duke përfshirë aktivitetet që do të ndërmerren në të ardhmen për të plotësuar boshllëqet ligjore me të cilat ballafaqohen në praktikë. Më tej, institucionet me të cilat nevojitet bashkëpunimi vendor dhe ndërkombëtar, analizat për krim kibernetik dhe trajnimet e specializuara që duhet të organizohen në ngritjen e kapaciteteve në luftimin e krimit kibernetik, teknologjisë informative e komunikuese, duke e zbatuar kornizën ligjore që aplikohet për këtë lloj të krimit, si dhe reformat legjislative në përputhshmëri të legjislacionit përkatës dhe harmonizimin me legjislacionin e BE-së.

Kjo punëtori ishte frytdhënëse veçanërisht për

pjesëmarrësit e vendeve të Ballkanit Perëndimor që janë pjesë e këtij projekti, përkatësisht përfaqësuesit nga Kosova, Bosnja, Maqedonia, Shqipëria, Serbia, Mali i Zi, dhe Turqia, meqë janë marrë informacione për teknikat më të avancuara të një trajnuesi nga ekspertët e specializuar për këtë lëmi.

Gjithashtu janë shkëmbyer përvojat me pjesëmarrësit e të gjitha vendeve për problemet e shumta dhe sfidat që hasin në këtë fushë si dhe janë adresuar çështjet në interes të fuqizimit të bashkëpunimit në të ardhmen.

Në përbërje të delegacionit nga Kosova ishin: Laura Pula, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Ikramije Bojaxhiu, Prokurore në Prokurorinë Themelore, Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, Skënder Çoçaj, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren si dhe Vesel Ismajli, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, të cilët ndërmjet këtij trajnimi janë përgatitur që të zbatojnë trajnimet e organizuara nga Akademia e Drejtësisë në fushën e krimit kibernetik.



Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe komerciale në BE

Nga data 26 - 30 qershor 2017, në mbështetje të GIZ-it është organizuar trajnimi regional "Ligji i BE-së", përkatësisht me temë: "Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe



komerciale në BE", i cili është mbajtur në Ohër të Maqedonisë.

Gjatë këtij trajnimi janë diskutuar çështjet lidhur me aplikimin e të drejtës së BE-së në procedurat dhe vendimet e Gjykatave të vendeve të Evropës Juglindore, e po ashtu edhe çështjet lidhur me bashkëpunimin juridik në lëminë civile dhe komerciale në këto vende. Pjesëmarrësit e këtij trajnimi kanë paraqitur

punimet e tyre me këtë temë për të kontribuar në krijimin e praktikave më të mira në bashkëpunimin gjyqësor në çështje civile dhe komerciale në BE.

Pjesëmarrës dhe përfitues të këtij trajnimi kanë qenë gjyqtarët nga shtetet e Evropës Juglindore, përkatësisht gjyqtarë nga Shqipëria, Mali i zi, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Maqedonia dhe Kosova. Në përbërje të delegacionit nga Kosova ishin gjyqtari Valon Totaj dhe Arsim Hamzaj, nga Gjykata



Themelore në Prizren.



<https://ad.rks-gov.net>

**Adresa “Lagjja e Spitalit”
Rr. Muharrem Fejza p.n
Prishtinë, Republika e Kosovës**

**Tel: + 381 38 200 18 660
Fax: + 381 38 512 095
E-mail: infoad@rks-gov.net**